

V E N D I M
Nr. 657, datë 18.12.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË RRREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RRREGULLORES SË ZBATIMIT TË
KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100, pika 2 të kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Neni 292 i Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 292

Modeli dhe karakteristikat e lejes së drejtimit (Neni 115 i Kodit Rrugor)

1. Leja për drejtimin e motomjeteve dhe të automjeteve është në përputhje me modelin evropian dhe ka përmasat e mëposhtme:

- a) lartësia 86.0 mm
- b) gjerësia 54.0 mm

Karakteristikat e tjera janë shënuar në modelin IV 2/A, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Për të shmangur rreziqet e falsifikimit të lejes së ndërtimit, ajo të prodhohet me material plastik, polikarbonat dhe me elemente të larta sigurie.

3. Karakteristikat e materialit, që përdoret për lejen e drejtimit, elementet e sigurisë së lartë kundër falsifikimit, mënyra e plotësimit të lejes së drejtimit dhe hollësi të tjera të nevojshme përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

4. Vendimet nr. 278, datë 20.6.2002 dhe nr. 375, datë 23.7.2002 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano